VENDIM
Nr.456, datë 22.6.2011

PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË KOMUNËS CAKRAN TË QARKUT TË FIERIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Cakran të qarkut të Fierit, që transferohen në pronësi ose në përdorim të kësaj komune, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista e inventarit me 50 (pesëdhjetë) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 295 (dyqind e nëntëdhjetë e pesë).

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Cakran për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha